



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.295/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Iniciativa Qytetare, Drejtësia Popullore, me seli në Leposaviq, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Lista Serbe, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Iniciativa Qytetare, Drejtësia Popullore, me seli në Leposaviq, Anr.295/2025, e datës 01.02.2025.
- II. Subjektit politik Lista Serbe, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00€ (katër mijë euro).
- III. Detyrohet Subjekti Lista Serbe, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025, PZAP ka pranuar një ankesë nga Iniciativa Qytetare, Drejtësia Popullore, me seli në Leposaviq, kundër subjektit politik Lista Serbe, në të cilën pretendon se ka parashtruar ankesë kundër gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve të bëra (thëna) nga ana e Elek Zlatan (Kryetar i Listës Serbe) dhe Srdjan Vuloviqit (kandidat për deputet) në mitingun e Listës Serbe në Zubin Potok, të mbajtur në sallën e Shtëpisë së Kulturës “Kolashini i Vjetër”, më datë 31 janar 2025. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se të folurit e pjesëmarrësve të caktuar përmban elementet të cilat mundem të paraqesin kërcënime direkte dhe indirekte dhe potencialisht rrezikojnë sigurinë e qytetarëve.

Tutje në ankesë është theksuar se posaçërisht shqetësuese është deklarata e Srdjana Vuloviqit, i cili ju referua tregimit “Ortodoksja e zemëruar”, në të cilin gruaja e djeg bashkëshortin sepse

e ka ndryshuar besimin. Vuloviqi me këtë analogji e bëri të qartë se " tradhtia " nuk do të falet dhe se ata të cilët janë kundër Listës Serbe "do t'i paguajnë ose popullit ose Zotit". Kjo retorikë është absolutisht e papranueshme, sepse mund kuptohet si kërcënim implicit me dhunë kundër atyre që kundërshtojnë Listën Serbe. Gjithashtu, kryetari i Listës serbe Zlatan Elek po përdorë shprehjen "Ilumi tradhëtarë", po bën thirrje "për dëbimin e kryetarëve të rrem të komunave" dhe këmbëngul që "tradhtarët" duhet të reduktohen në "minimum", kjo deklaratë mund të kuptohet si një kërcënim serioz nga kundërshtarët politikë. Sipas parashtruesit të ankesës, deklaratat e mësipërme jo vetëm që përhapin gjuhën e urrejtjes, por përfaqësojnë shkelje serioze të parimeve themelore demokratike dhe të drejtën për shprehje të lirë politike. Edhe pse ato nuk janë thirrje të drejtpërdrejta për dhunë, këto deklaratat krijojnë atmosfera në të cilën kundërshtarët politik etiketohen si tradhtarët dhe në mënyrë implicite kërcënohen me pasoja. Në ankesë theksohet se kryetari i Listës Serbe, Zlatan Elek, si dhe kandidati për deputet Srdjan Vuloviq, kanë shkelur në mënyrën më flagrante nenin 34, par.1.7, nenin 34 par.1.11 dhe nenin 35 par.1 dhe 2 të LZP-së. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy linqe.

Lista Serbe më 02.02.2025 brenda afatit ligjor i ka paraqitur përgjigje në ankesë, PZAP-it, përmes emailit , në të cilën ka theksuar se ne i kemi shikuar pretendimet që janë dërguar në ankesë, ku thuhet se Srgjan Vulloviq po ritregon tregimin " Ortodoksja e Zemëruar " në të cilën, sipas rrëfimit të vetë historisë, një grua e ka djegur burrin e saj sepse ai ka ndërruar fenë. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se fjalimi i Srgjan Vulloviqit është, në kuptimin figurativ, një fjalim dashurie, jo një fjalim urrejtjeje, sepse vetë tregimi "Ortodoksja e zemëruar" ka të bëjë me një marrëdhënie dashurie midis një gruaje dhe një burri. Dashuria mes të dyve ishte aq e madhe sa që ajo nuk mund t'ia falte që e la atë dhe ndërroi fenë. Mirëpo, Iniciativa Qytetare, Drejtësia Popullore nga Leposaviqi po përpiqet të përdorë një analogji për të arritur në përfundimin se ky është një kërcënim dhe gjuhë urrejtjeje, në vend të dashurisë. Po ashtu, në përgjigje në ankesë ka theksuar se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk lejon që fjalimet politike apo historitë e dashurisë të interpretohen me analogji, por gjuha e urrejtjes duhet t'i referohet një subjekti politik ose personave të caktuar, duke qenë se Srgjan Vulloviq nuk është grua, por mashkull, ai nuk mund të të vihet në personazhin "Ortodokses së zemëruar" dhe nga kjo nuk mund të konkludohet me analogji se Srgjan Vulloviq si grua kërcënon një burrë jo besnik. Përkundrazi, është shumë më e lehtë të konkludohet se me rrëfimin e kësaj historie, Srgjan Vulloviq ka dashur t'u kujtojë të gjitha grave që t'i ftojnë burrat e tyre të votojnë me ta, sepse gruaja në një familje serbe është shtylla e vetë familjes. Prandaj, ne besojmë se fjalimi i Srgjan Vulloviqit, as drejtpërdrejt e as me analogji, i cili nuk lejohet në ligjin penal dhe kundërvajtje, nuk përmban elemente të kundërvajtjes, e aq më pak gjuhë urrejtjeje. Përmes përgjigjes në ankesë ka propozuar që PZAP-i ta miratojë përgjigjen në ankesë si të bazuar, ndërsa ta refuzojë ankesën si të pabazuar, sepse pretendimet në ankesë bazohen në analogji në një vepër letrare.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidati për deputet, nga subjekti politik Lista Serbe Serdjan Vuloviq i cili gjatë fushatës ka deklaruar duke iu referuar tregimit, “Ortodoksja e zemëruar”, duke përdorur fjalët “në të cilin gruaja e djeg bashkëshortin sepse e ka ndryshuar besimin, se “tradhtia” nuk do të falet dhe se ata të cilët janë kundër Listës Serbe “do t’i paguajnë ose popullit ose Zotit” dhe deklarata tjetër e kryetarit të Listës Serbe Elek Zlatan i cili ka përdorur fjalët “llumi tradhtarë”, bën thirrje “për dëbimin e kryetarëve të rrem të komunave” dhe këmbëngul që “tradhtarët” duhet të reduktohen në “minimum”, gjen se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”, andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjektit politik Lista Serbe përkatësisht, nga kryetari i këtij subjekti Elek Zlatan dhe kandidati për deputet i këtij subjekti Serdjan Vuloviq, ndaj Iniciativës Qytetare Drejtësia Popullore, në fushatë zgjedhore është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në media online, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kryetari i subjektit dhe kandidati për deputet sipas Panelit është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që përdorin fjalë si “tradhtia” dhe “llumi tradhtarë” për të sulmuar individë, grupe apo organizata të caktuara mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt dhe të ndarë, duke shkelur kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektueshme.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatësisht faktin se i njëjti subjekt në këtë fushatë zgjedhore nuk është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Në lartësinë e gjobës paneli ka marrë për bazë faktin se subjekti politik në fjalë është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.295/2025, datë 04.02.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.